



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-61
Prishtinë, më 21 prill 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 21 PRILL 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slobodan Petroviq dhe Xhezair Murati.

Mungoi: Ibrahim Gashi

Nga shefat e Grupeve Parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Lulëzim Zeneli, Ardian Gjini, Myfera Shinik dhe Slavisa Petkoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Salih Rexhepi, Naim Abazi dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Petrit Hysaj

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe dy pika shtesë.

Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit të Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 prill 2009,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës më 30 prill 2009,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë të mbajtur më 6 prill 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 prill 2009 u miratua pa vërejtje.

Sabri Hamiti pati vërejte në Transkript, në faqen 12, ku ishte evidencuar "...ka qenë i ndikuar prej zotit Demi e të tjerëve", kurse duhet të jetë: " ka qenë i **ndihmuar** prej zotit Demi e të tjerëve", që është përmirësuar.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancë plenare më 30 prill 2009:

Pas shqyrtimit të pikave të lartshënuara, Kryetari konstatoi se rendi i ditës për Seancën e ardhshme Plenare u miratua në tërësi.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e Zyrës së Auditorit Gjeneral për të hyrat dhe shpenzimet e RTK-së për vitin 2007

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e Zyrës së Auditorit Gjeneral për të hyrat dhe shpenzimet e RTK-së për vitin 2007, vendosi që Raportin ta radhis në rend dite të seancës plenare, për shqyrtim.

3.2 Rekomandimi i Komisionit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Propozimi i Komisionit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës t'i dërgohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, për konsultim.
2. Qeveria e Kosovës duhet që, në afatin prej 15 ditësh, Kuvendit t'ia paraqesë mendimin e saj lidhur me rekomandimet e Komisionit përzgjedhës.

3.3 Mocioni i deputetit Riza Smaka, për të udhëzuar Qeverinë për të përgatitur ndryshimin e Rregullores nr.2003/13 për transformimin e të drejtës për përdorimin e pronës së paluajtshme në pronën shoqërore

Kryesia, pasi shqyrtoi mocionin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta hartojë Projektligjin për normimin e materies lidhur me përdorimin e pronës së paluajtshme në pronësi shoqërore, e cila deri më tani ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/13.

3.4 Propozimi i një grupi të deputetëve për të debatuar lidhur me gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia mbështet Mocionin e dymbëdhjetë (12) deputetëve për të debatuar në Kuvend lidhur me gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.
2. Kërkohej nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ta hartojë një informatë mbi gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.
3. Informata e kërkuar sipas paragrafit një të këtij përfundimi, t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës në afatin sa më të shkurt të mundshëm, në mënyrë që në pjesën e parë të muajit maj 2009 të debatohet për temën e cekur më lart.
4. Të ftohet Guvernatori i BQK të marrë pjesë në seancë plenare kur të debatohet për gjendjen në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.5 Kërkesa e Komisionit Ad Hoc për kompensimin e punës për përzgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

V E N D I M

- 1 Lejohet kompensimi i anëtarëve të Panelit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës në shumën prej 50€, ndërsa 30€ për stafin mbështetës të komisionit, për çdo mbledhje të mbajtur.
- 2 Kompensimi, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, të realizohet sipas evidencës për pjesëmarrje në mbledhje.

3.6 Rekomandimi i Komisionit për punë të jashtme lidhur me nismën për formimin e Grupit të Miqësisë në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Bundestagut të Gjermanisë

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia mbështet nismën e Komisionit për Punë të Jashtme për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Bundestagut të Gjermanisë.
2. Grupi i Miqësisë do të përbëhet nga një deputet prej secilit grup parlamentar të Kuvendit dhe sekretarit të grupit.
3. Kërkohet nga grupet parlamentare që ta caktojnë nga një anëtar në Grupin e Miqësisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Bundestagut të Gjermanisë.
4. Propozimet t'i dërgohen Kryesisë së Kuvendit, për mbledhjen e ardhshme.

3.7 Rekomandimi i Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me nismën për formimin e Grupit të Miqësisë në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia mbështet nismën e Komisionit për Punë të Jashtme për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar.
2. Grupi i Miqësisë do të përbehet nga një deputet prej secilit grup parlamentar të Kuvendit dhe sekretari i grupit.
3. Kërkohet nga grupet parlamentare që ta caktojnë nga një anëtar në Grupin e Miqësisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar.
4. Propozimet t`i dërgohen Kryesisë së Kuvendit, për mbledhjen e ardhshme.

3.8 Kërkesa e Bordit Botues të Buletinit të Kuvendit për ndarje mjetesh dhe kompensim të anëtarëve të Bordit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

V E N D I M

1. Fjala “Bord” ndryshohet dhe riemërohet “Këshill Botues”.
2. Fjala “Buletini i Kuvendi” ndryshohet dhe riemërtohet “**K u v e n d i**”.
3. Fjala “Buletin” ndryshohet dhe quhet “Revistë”.
4. Mjetet për botimin e “Revistës së Kuvendit” janë të siguruara në buxhetin e Kuvendit.
5. Kompensimi i deputetëve – anëtarë të Këshillit Botues- bëhet sipas praktikave për kompensimin e punës në komisionet parlamentare.

3.9 Njoftimi i deputetit të PDAK-së z. Danush Ademi, për bashkëngjitje Grupit parlamentar te AAK-së

Kryesia u njoftua,që deputetit të PDAK-së z. Danush Ademi është bashkëngjitur Grupit parlamentar te AAK-së

3.10 Njoftimi me Raportin e delegacionit parlamentar të Kuvendit të Kosovës nga seminari i mbajtur në Parlamentin Evropian

Kryesia u njoftua me Raportin e delegacionit parlamentar të Kuvendit të Kosovës nga seminari i mbajtur në Parlamentin Evropian.

3.11 Shqyrtimi i kërkesës së Kabinetit të Kryetarit për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përbërje: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Naim Maloku dhe Xhezair Murati, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, si dhe Mehmet Hajrizi, Skender Reçica dhe Agron Krasniqi, nga Kabineti i Kryetarit, në Kroaci, prej datës 27 deri më 30 prill 2009.
2. Shpenzimet e akomodimit (fjetja) mbulohen nga organizatori, ndërsa shpenzimet e transportit, mëditjet e ushqimit, si dhe shpenzimet e tjera, që nuk i mbulon organizatori, përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**